



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022  
Nr. Dok.202101727/4

**Lënda:** *Rekomandim për rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, duke garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
Tiranë

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**  
Tiranë

*Të nderuar,*

Në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me shumë vëmendje diskutimet dhe debatet publike mbi propozimin e hartës së re gjyqësore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Nisur nga ndjeshmëria e veçantë e kësaj çështjeje, por njëkohësisht edhe nga ankesat e paraqitura nga qytetarët në institucion, sidomos ata që u përkasin grupeve vulnerabël, është filluar hetimi i rastit me iniciativë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgatitur dhe prezantuar në muajin shtator 2021 një Propozim Raport Vlerësimi mbi hartën e re gjyqësore<sup>1</sup> të hartuar nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim. Materiali është rezultat i një pune të thelluar dhe voluminoze.

Në vijim, ky organ në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë organizoi një cikël prej 8 takimesh konsultative gjatë periudhës janar – mars 2022 me grupet e interesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në juridiksionet e gjykatave të apelit, përfaqësues nga dhomat vendore të avokatisë, përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, gjyqtarë dhe nëpunës civil gjyqësorë, përfaqësues të shoqërisë civile etj, në disa prej të cilave kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit. Gjithsesi, pavarësisht këtyre përpjekjeve për të mbledhur opinionet, sugjerimet e rekomandimet e grupeve të interesit, vlerësojmë se ky proces duhet të kishte filluar më herët, duke garantuar mundësi dëgjimi dhe reflektimi që në fazën fillestare të ideimit të kësaj harte.

Sipas dispozitave të ligjit nr.98/2016<sup>2</sup> “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, riorganizimi i rretheve gjyqësore është një proces, i cili duhet të kryhet çdo 5 vjet. Institucionet kompetente për këtë proces janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Më pas, projektpropozimi duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili duhet të japë zgjidhje edhe për çështje të tjera si kostot financiare që kanë të bëjnë me godinat, kostot e ndërtimit, planifikimit, shërbimet mbështetëse etj.

Sipas nenit 14 të ligjit nr.98/2016, kërkohet që procesi i rivlerësimit të shpërndarjes së rretheve gjyqësore të bëhet bazuar në 3 kritere:

a) garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;

---

<sup>1</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE.pdf>

<sup>2</sup> Neni 13 i ligjit:

“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor bën vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet.

2. Në rast se nga vlerësimi rezulton se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave.

3. Përpara se të miratojnë propozimin e përbashkët, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë marrin mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrin të Financave dhe këshillohen me palë të tjera të interesuara.

4. Procesi për caktimin ose caktimi rishitas i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore të gjykatave kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, dhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës.

5. Propozimi i përbashkët i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrin të Drejtësisë për hartën gjyqësore i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave nga Ministri i Drejtësisë.”

- b) uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;
- c) rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Po kështu, neni 15 i po këtij ligji parashikon parimet dhe kriteret për përcaktimin e kompetencave tokësore:

*“1. Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në rrethe gjyqësore, që është njësi ku funksionon një gjykatë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Një rreth gjyqësor mund të mbulojë një ose më shumë njësi të pushtetit vendor.*

**2. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe gjykatat e posaçme i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore mbi të paktën dy rrethe gjyqësore.**

**3. Rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:**

a) ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, **infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike;**

b) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, efikasitetin e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, **burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.**

**4. Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe për të siguruar specializimin në gjykata, numri minimal i gjyqtarëve do të jetë:**

a) gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku shtatë gjyqtarë;

b) gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku dhjetë gjyqtarë;

c) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë përbëhen nga së paku 16 gjyqtarë;

ç) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të apelit përbëhen nga së paku 11 gjyqtarë.

**5. Secili gjyqtar që ushtron funksionin në gjykata me juridiksion të përgjithshëm ose në gjykata administrative duhet të ketë një numër mesatar të çështjeve gjyqësore në vit, jo më të ulët se mesatarja e çështjeve gjyqësore për gjyqtar në vit në të njëjtën shkallë gjykimi, në tri vitet e fundit.”**

Në propozimin e fundit të miratuar nga KLGJ është parashikuar:

- Nga 22 Gjykata të Shkallës së Parë (me juridiksion të përgjithshëm) të ngelen 13;
- Nga 6 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë të ngelen 2;
- Nga 6 Gjykata Apeli në gjithë Shqipërinë të ngelet vetëm një në Tiranë.

Në ankesat e paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, nga qytetarët janë parashtruar një numër jo i vogël shqetësimesh, ndër të cilat mund të përmenden se:

*“Ngritja e gjykatave sa më afër popullsisë është bërë më qëllim ardhjen në ndihmë të qytetarëve, jo përqendrimin e tyre larg vendbanimeve;*

*Përqendrimi i një gjykatë të vetme Apeli në Tiranë është barrë e shtuar për palët, për arsye se pagesa e shërbimeve avokatore do të rritet ndjeshëm, për shkakun e shpenzimeve për vajtje-ardhje e akomodim, që rëndon në ekonomitë familjare të qytetarëve;*

*Duke qenë se aktualisht, në gjykatat e apelit po bëhet delegimi i gjyqtarëve nga një gjykatë në tjetrën, për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve në dispozicion, qytetarët ngrenë dyshimin se mos ndoshta këto shpenzime kërkohen të kalojnë nga shteti tek ata;*

*Kjo nismë do të bëjë më të vështirë marrjen e drejtësisë nga qytetarët, të cilët do të sfiliten deri sa të ndahen nga jeta e nuk do të mund të kenë mbaruar proceset gjyqësore;*

*Për këtë arsye, është e domosdoshme që gjykatat e apeleve të plotësohen sa më shpejt me personelin e nevojshëm.”*

Gjithashtu, për t’u evidentuar është fakti se nga inspektimet e kryera nga grupet e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në disa Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si nga të paraburgosurit/dënuarit, po ashtu edhe nga stafi administrativ janë ngritur shqetësime lidhur me projektin e hartës së re të shpërndarjes së gjykatave, sipas së cilës gjykatat e apelit do të shkrihen dhe do të ngelet vetëm Gjykata e Apelit Tiranë.

Sipas tyre, ky proces nëse do të ndodhë, do të sillte vështirësi të mëdha organizative dhe ngarkesë në buxhet, pasi gjatë vitit kryhen një numër i konsiderueshëm shoqërimesh të të burgosurve me automjete jashtë IEVP-ve për në Gjykatat e Apelit dhe kjo shifër do të ishte më e madhe nëse numri i gjyqtarëve do të ishte i plotësuar. Nëse do të jetë vetëm një gjykatë apeli, për shkak të burimeve njerëzore të kufizuara por edhe mjeteve në dispozicion, vështirësitë do të jenë edhe më të shumta për këtë kategori personash, por edhe të shërbimeve të kryera nga policia e burgjeve.

Në Raportin e Vleresimit të KLGJ-së, ndër të tjera, përmendet se do të vijë në ndihmë të zbatimit të këtij projekti infrastruktura e përmirësuar dhe përdorimi më i mirë i teknologjisë së komunikimit, sikurse është përdorimi i telekonferencës.

Në një kohë, kur edhe pse është me shumë rëndësi përfshirja e një treguesi për kohën e nevojshme të udhëtimit të qytetarëve për në gjykatë, duke përdorur transportin publik, pavarësisht se Grupi i Punës i ka kërkuar të dhëna Autoritetit Rrugor Kombëtar, pas leximit me kujdes të materialit të prezantuar, evidentohet se nuk ka të dhëna të disponueshme.

Duhet të evidentojmë faktin se mjetet dhe llojet e transportit publik në Shqipëri nuk janë të zhvilluara si në vendet e tjera evropiane, duke shtuar këtu edhe rritjen e çmimit të karburantit dhe shtrenjtimin e kostove të udhëtimit, të cilët janë faktorë që do të ndikojnë në kufizimin e transportit në të ardhmen dhe në rritjen e kostove për përballimin e shpenzimeve gjyqësore.

Pavarësisht se mendohet që zhvillimi i seancave gjyqësore me video është një faktor tjetër i cili mund të ndikojë në nevojën për afërsi fizike me gjykatat dhe do të ulë kështu nevojën për të transportuar të burgosurit nga dhe për në gjykatë, mjafton vetëm të përmendim sesa të papërgatitur u gjetëm në vitin 2020 e në vijim, gjatë kohëzgjatjes së pandemisë, për të përdorur në të gjitha institucionet teknologjinë e informacionit. Pa përmendur pamundësinë reale të qytetarëve të tjerë për të aksesuar në këtë teknologji, për shkak të vështirësive ekonomike, sikurse janë grupet e margjinalizuara, pensionistët etj.

Avokati i Popullit vlerëson se ky propozim nuk e përmirëson aspak aksesin në drejtësi, por përkundrazi e cenon këtë parim, duke passjellë:

- shkeljen e parimit të aksesit në drejtësi;
- rritjen e kostove për qytetarët;
- cilësinë dhe përshtatshmërinë joadekuate të shërbimeve të ofruara.

### **-Cenimi i aksesit në drejtësi dhe largësia e gjykatave**

Shteti duhet t'i garantojë çdo individ akses në drejtësi, kohë dhe burime financiare për t'u dëgjuar dhe përfaqësuar. Sipas këtij propozimi mbyllet 9 gjykata në shkallë të parë (me juridiksion të përgjithshëm), ndryshimi më drastik në këto 30 vite në të gjithë rajonin.

Sipas të dhënave krahasuese të publikuara nga Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për efikasitetin e drejtësisë (CEPEJ) në lidhje me sistemet gjyqësore të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, numri i gjykatave për 100,000 banorë është tashmë nën mesataren evropiane. Ky numër për Shqipërinë ishte afërsisht 1.3 në 2018, ndërsa mesatarja evropiane është afërsisht 1.5. Nëse do të miratohet

propozimi, ky indikator do të përkeqësohej nga ana tjetër, referuar Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020 të dhënat tregojnë të njëjtën situatë kur bëhet fjalë për numrin e gjyqtarëve për 100,000 banorë. Ky numër është afërsisht 11, ndjeshëm më i ulët se mesatarja evropiane prej 21 gjyqtarësh për 100,000 banorë<sup>3</sup>. Prandaj, mbyllja e këtyre gjykatave në kuadër të kësaj harte të propozuar, vetëm sa ul numrin e gjykatave dhe gjyqtarëve për 100,000 banorë.

Garantimi i aksesit në drejtësi lidhet me afërsinë e individit me gjykatën: mbyllja e gjykatave është një proces që ka ndodhur më parë në vende të tjera, përfshirë Shqipërinë, por është zbatuar kriteri i mësipërm, pasi ka pasur zhvillime infrastrukturore dhe zhvendosje të popullsisë gjatë viteve.

Vlen të theksohet se Grupi i Punës ka përllogaritur se ka matur afërsinë e individit me gjykatën në bazë të aplikacionit "Google map" që nuk rezulton për shkak të infrastrukturës shumë efikas dhe i saktë në Shqipëri. Pavarësisht kësaj, koha që do t'i duhet një individ është mesatarisht nga 2 orë e 30 minuta deri në 3 orë dhe 30 minuta, përkatësisht vetëm për gjykatat e shkallës së parë.

Duke mbyllur plotësisht 5 gjykata aktuale të apelit dhe duke lënë vetëm Gjykatën e Apelit Tiranë, qytetarët duhet të shkojnë në këtë gjykatë me një distancë që varion në kohë udhëtimi nga 2.5 orë deri në maksimum 5 orë. Pra, një individ që jeton afër kufijve do t'i duhen, sipas KLGJ-së (bazuar në aplikimet e përdorura në SHBA dhe BE), 5 orë kohë transporti për të ardhur dhe 5 orë për t'u kthyer, pra vetëm 10 orë udhëtim, për të ndjekur një proces gjyqësor. Ky propozim nuk përmirëson aksesin në drejtësi, pra afërsinë e individit me gjykatën, por përkundrazi e shkel këtë parim.

### **-Rritje e kostove**

Ky projekt shoqërohet me rritjen e konsiderueshme të kostove, si për qytetarët, po ashtu edhe për buxhetin e shtetit. Problemi kryesor i projektit është se i mungon një studim fizibiliteti si dhe një planifikim për kohën e vendosjes dhe zbatimit të tij në praktikë.

Përqendrimi i gjykatave dhe prokurorive, do të kërkojë ndërtesa dhe personel ndihmës/mbështetës më të mëdha për to, kështu do të kërkohej një studim fizibiliteti që nuk gjendet në materialin e KLGJ-së (d.m.th. rritja e kostove për buxhetin e shtetit, taksat e qytetarëve dhe jo reduktimi i tyre; përdorimi joefikas i sistemit të burgjeve, etj.)

### **-Cilësia dhe përshtatshmëria e shërbimeve të ofruara nuk rritet**

---

<sup>3</sup> Sipas Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020, Shqipëria ka pasur 307 gjyqtarë me kohë të plotë (10.8 për 100,000 banorë) dhe 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit Europian për Eficiencën në Drejtësi (CEPEJ), mesataret evropiane janë 21 gjyqtarë/12 prokurorë për 100,000 banorë. (faqe 21 e Raportit)

Për më tepër, shih linkun:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

Për të analizuar këtë kriter themelor bazuar në të dhënat aktuale statistikore, një individ i nevojiten 3-6 muaj për të përfunduar një proces në Shkallën e Parë në rrethet Pukë, Shkodër, Pogradec, Korçë, Vlorë dhe 6-10 muaj në Gjykatën e Apelit.

Për shkak të numrit shumë të lartë të çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Administrativ<sup>4</sup>, sot u duhen 3-4 vite në Apel dhe jo më pak se 7 vite në Gjykatën e Lartë.

Nëse do të pranohet propozimi për mbylljen e gjykatave të apelit, atëherë të paktën individët e 5 rretheve të tjera do t'i bashkohen fatkeqësisë së atyre të qarkut të Tiranës që do të duhet të presin të paktën 3-5 vjet për proceset gjyqësore, sepse gjyqtarët e Gjykatës Kombëtare të Apelit (e vetmja e propozuar në shkallë vendi) do t'i trajtojnë çështjet e tyre si çështje në pritje.

### **-Krahasimi me vendet e tjera**

Përveç Kosovës, e cila ka një sipërfaqe dhe popullsi shumë më të vogël se Shqipëria, asnjë vend evropian nuk ka vetëm një Gjykatë të Apelit siç është propozuar. Kështu, Maqedonia e Veriut ka 4 gjykata apeli; Sllovenia ka 4 gjykata apeli; Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës ka 16 gjykata kantonesh, të cilat shqyrtojnë apelet e gjykatave të shkallës së parë; në Kroaci 15 gjykatat e kontesë shqyrtojnë apelet nga gjykatat bashkiake të shkallës së parë. Lituania ka 5 gjykata apeli; Sllovakia ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 8 gjykata apeli. Por edhe vetë Danimarka si shtet i zhvilluar ka një sistem gjyqësor me tre shkallë, me 2 gjykata apeli<sup>5</sup>.

Më tej, vihet re se studimi i kryer nga KLGJ është bazuar kryesisht në modelin danez të organizimit të drejtësisë. Duhet theksuar fakti se realiteti i Shqipërisë dhe ai i Danimarkës nuk janë të ngjashëm në këtë drejtim, kjo lidhet me disa faktorë si realiteti social dhe ekonomik, efektiviteti i sistemit të drejtësisë dhe i sistemit administrativ etj. Për të bërë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të shpërndarjes së gjykatave për 100 000 banorë, nevojitet një studim i numrit të çështjeve për 100 000 banorë.

Sipas raportit, në Danimarkë, në vitin 2007, u vendos që të mos eliminoheshin ndërtesat e gjykatave, nëse koha e udhëtimit e tejkalonte afërsisht 1 orë (por, disa

---

<sup>4</sup> Sipas Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, një ndër gjykatat me nivelin më të lartë të çështjeve të prapambetura është Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit ka 15 178 çështje nga të cilat 7 463 janë më të vjetra se dy vite. Ndërsa norma e evadimit është 37%.

Për më tepër, shih linkun:

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

<sup>5</sup> Raporti i Vlerësimit i KLGJ-së.

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

prej këtyre gjykatave u bënë degë të gjykatave të tjera). Çdo gjykatë apeli ka tre vendndodhje dytësore të gjykatës.

Asnjë nga vendet europiane me sipërfaqe dhe popullsi të ngjashme me Shqipërinë, nuk ka vetëm një Gjykatë Apeli, sikurse është propozuar dhe se modelet që kemi prodhuar në këto 30 vite me një Gjykatë Apeli (ajo e viteve 1993-1994 dhe Gjykata Administrative e Apelit) për hir të së vërtetës kanë rezultuar të pasuksesshme.

Çmujmë se, harta e re e Gjyqësorit nuk është projektuar me qëllimin për të siguruar ofrimin e aksesit adekuat të qytetarëve në gjykata, por për të adresuar numrin e ulët të gjyqtarëve që janë aktualisht në sistemin e drejtësisë.

Ajo që mbetet tepër shqetësuese dhe në konsideratë të veçantë të Avokatit të Popullit janë shtresat me të ardhura të pamjaftueshme, të cilat përbëjnë një numër të konsiderueshëm të popullsisë shqiptare (Të dhënat tregojnë që megjithëse varfëria relative ka ardhur në ulje të pakonsiderueshme nga 23.7 (në vitet 2017-2018 1) në 23.4 në vitin 2018, përqindja e popullatës që janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta është 49%, që do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike<sup>6</sup>).

Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.211, datë 10/06/2022 *“Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”* përbën një shkelje dhe kufizim të të drejtave, sepse do të shkaktojë mungesë aksesit në drejtësi edhe për viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore dhe viktimat nga veprat penale të ngacmimit seksual, marrëdhënive seksuale me dhunë me të rritur e të mitur.

AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri<sup>7</sup>, si dhe organizata të tjera jofitimprurëse të cilat punojnë për të drejtat e vajzave dhe grave në të gjithë vendin, kanë adresuar shqetësimet e tyre si në KLGJ, po ashtu edhe në media, sa i përket aksesit në drejtësi të kategorisë së grave dhe viktimave të dhunës.

Kështu, sipas propozimit për *“Hartën e re gjyqësore”* sistemi i MKR-së i vendosur në bashkitë e vendit si një reagim i koordinuar ndaj dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje, do të hasë vështirësi në funksionimin normal, për të cilin është advokuar dhe lobuar prej shumë vitesh që të ngrihet e të jetë funksional në çdo bashki të vendit. Të mbijetuarat/it e dhunës duhet të lejohen të paraqesin ankesa, kërkesa, si edhe të dëgjohen e të përfaqësohen në bashkitë ku ato jetojnë dhe punojnë, pasi kjo është një e drejtë që iu jepet nga ligj nr.121/2016 *“Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*.

---

<sup>6</sup> UN Country Report for Albania, 2020.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebbsite/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>

<sup>7</sup> <https://www.zeriamerikes.com/a/6617479.html>



Afatet e përpilimit të kërkesave për lëshimin e urdhrin paraprak të mbrojtjes, urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme deri në gjykim variojnë nga 24-48 orë dhe viktimat lajmërohen me telefon nga gjykata. Për këtë arsye, mendojmë se një riorganizim i tillë i sistemit gjyqësor, do të çojë në lëshimin e vendimeve pa praninë e palëve gjyqësore në proces, në rastin më të mirë vetëm me praninë e dhunuesit.

Në këtë propozim nuk ka detaje në terma konkretë dhe nuk janë parashikuar të gjitha kostot që nevojiten deri në momentin e paraqitjes në gjykatë për të fituar të drejtat e viktimës së dhunës në familje, me qëllim rehabilitimin dhe eliminimin e dhunës sipas legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare.

Propozimi për të ndryshuar hartën e sistemit të drejtësisë, në vlerësimin tonë do të rrisë kostot e viktimave të dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje, përfshirë këtu fëmijët, viktimave të dhunës me bazë gjinore, familjeve në nevojë/qendrave rezidenciale për viktimat e dhunës në familje dhe PAK. Po ashtu, kostot do të rriten edhe për OJF-të të cilat punojnë dhe janë në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, si dhe financohen kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë, për arritjen e qëllimit të tyre, pasi e kanë të mirëpërcaktuar çdo shpenzim buxhetor.

Njëkohësisht, duke parë zbatimin e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka paraqitur vështirësi të dukshme në përfitimin e ndihmës juridike detyësore, si pasojë e moszbatimit të vendimeve gjyqësore nga ana e dhomave vendore të avokatisë, por edhe nga ulja e buxhetit për ndihmën juridike, jemi të mendimit se me një hartë të re gjyqësore këto problematika do të thellohen, duke mohuar drejtësinë për këto kategori.

## **Parimi i aksesit në drejtësi dhe rëndësia e tij**

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup>). Mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, jo vetëm cenon të drejtën e ankuesit për një proces të rregullt ligjor, por për më tepër, zvarrit eventualisht përfitimet.

---

<sup>8</sup> Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Ndryshimet e vitit 2017 në Kodin e Procedurës Civile synojnë të rrisin garancinë për gjykime më efektive, reduktimin e zvarritjes së procesit gjyqësor dhe afatet që duhet të përmbushen gjatë gjykimit të një çështjeje.

E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe funksionimin e drejtësisë në vend. Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se të drejtat e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.<sup>9</sup>

Aksesi në drejtësi është konsideruar si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me nenin 6 të KEDNJ, duke nënkuptuar jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi.

Në procesin e rregullt ligjor, aksesin në drejtësi duhet kuptuar si elementi parësor për ekzistencën e elementeve të tjera të tij, si e drejta për t'u dëgjuar brenda një

<sup>9</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.52, datë 14.11.2014. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 18.07.2008; nr. 5, datë 06.03.2009 dhe nr. 48, datë 24.09.2014.

afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Nëse qytetarit nuk i garantohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, atëherë të drejtat e tjera nuk kanë kuptim dhe nuk mund të qëndrojnë pa të parën. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se normat dhe parimet kushtetuese, ku bën pjesë edhe e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për të pasur një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar mbi të<sup>10</sup>.

Gjatë shqyrtimit, gjykata, në ushtrimin e funksioneve të saj, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, me qëllim vendosjen në vend të një të drejte të cenuar nga një akt i pushtetit publik, ka për qëllim kontrollin e këtyre të fundit për respektimin e parimeve kushtetuese e ligjore në funksion të realizimit të drejtësisë. **Në një shoqëri demokratike e drejta e individit për t'u dëgjuar nga gjykata është një garanci e domosdoshme për të respektuar të drejtat dhe liritë e tjera themelore të shtetasve në një shtet të së drejtës.**

Duke iu referuar edhe praktikës së GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si element përbërës i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ, është pranuar se vendimet e autoriteteve administrative duhet t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë, i cili duhet të sigurojë garancitë e tjera të kësaj Konvente.

GJEDNJ ka vlerësuar vazhdimisht se kjo e drejtë është thelbësore dhe ka karakter parësor në një shoqëri demokratike për shkak të pasojave që ka në interesat legjitime të individit.

Parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gjyqësorit kërkojnë gjithashtu ekzistencën edhe të mekanizmave që garantojnë realizimin efektiv të tyre. Kriteri i aksesit në gjykatë është i përmbushur në qoftë se vendimet e autoriteteve administrative i nënshtrohen kontrollit të organit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë.

Përsëri lidhur me legjitimitimin, por në këtë rast duke iu referuar mohimit të drejtës për të paraqitur padi për shkak të tejkalimit të afatit, GJK ka theksuar se *“e drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi...”*<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5/2009; nr.15/2003; nr.9/2003; nr.17/2005.

<sup>11</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.8/2008.

Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesimi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

...GJEDNJ shprehet se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë efektive dhe jo formale. GJEDNJ duke marrë **në shqyrtim barrierat financiare për t'iu drejtuar gjykatës ... përcaktoi se këto barrierat duhet të analizohen rast pas rasti, në përputhje me mundësitë reale që ka paditësi dhe jo të merret në shqyrtim një mundësi abstrakte për të paguar nga ana e personit që kërkon të vërë në lëvizje gjykatën...**<sup>12</sup>

Ndërhyrja që kufizon të drejtat e shtetasve, në asnjë rast, nuk mund të cenojë thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Gjykata ka argumentuar se duhet një analizë e kujdesshme nga ana e organit vendimmarrës në lidhje me mjetin e përdorur për të arritur qëllimin e ligjshëm.

Para së gjithash, mjeti i përdorur duhet të jetë efikas, në mënyrë që të mos kemi një cenim a mohim të të drejtave të individëve pa u arritur realizimi i interesit publik, në funksion të së cilit është hartuar norma juridike. Mjeti duhet të jetë i tillë që të shmangë sa më shumë të jetë e mundur kufizimet e të drejtave të individëve në raport me rezultatet që kërkohen të arrihen. Ky konkretizim i parimit të proporcionalitetit detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e të drejtës së individëve.

“...procesi i rregullt ligjor ka si element përbërës, midis të tjerash, edhe të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesimi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.”

Ky qëndrim i GJK ka qenë në përputhje të plotë edhe me praktikën e GJEDNJ, e cila lidhur specifikisht me karakterin e gjykimit në gjykatat më të larta të një vendi ka konstatuar se vendimet gjyqësore gjithmonë ndikojnë mbi personat. Është e vërtetë që neni 6/1 i KEDNJ nuk kërkon nga shtetet themelimin e gjykatës së apelit ose të Kasacionit. Megjithatë, një shtet i cili i ka këto gjykata, është i detyruar të sigurojë se personat që i drejtohen ligjit do të gëzojnë përpara këtyre gjykatave garancitë themelore të parashtruara në nenin 6 të KEDNJ. Në një shoqëri demokratike në kuptimin e Konventës, e drejta për një administrim të

---

<sup>12</sup> Çështja *Albert dhe Le Compte k. Belgjikës*, 10 shkurt 1983.

mirë të drejtësisë zë një vend kaq të dallueshëm, sa që asnjë interpretim i ngushtë i nenit 6/1 nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e kësaj dispozite<sup>13</sup>.

Në këtë linjë, sjellim në vëmendje që në muajin tetor 2021, GJEDNJ ka vendosur për rastin e dy kërkuesve, *Bara and Kola v. Albania*, shtetas shqiptarë që janë ankuar pranë këtij institucioni për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri. Kjo Gjykatë ka vendosur se në këto raste *është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*.<sup>14</sup>

Duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat e thella të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vettingut, Gjykata ripohoi **se shtetet kishin një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm**.

Së fundmi, ndonëse nuk i takonte Gjykatës të vendoste për interpretimin e duhur të ligjit të brendshëm, ajo konsideroi se qasja e Gjykatës së Lartë në çështjen e aplikantit të parë për të mosllogaritur efektet e reformave të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë në funksionimin e tij në shtrirjen e përgjithshme të procedurave, në këto rrethana, nuk do të ishin në përputhje me jurisprudencën e saj sipas nenit 6 paragrafi 1 mbi kërkesën e “*afatit së arsyeshëm*”, pasi mund të zhvendoste tek palët ndërgjyqëse individuale barrën e plotë të çdo vonese të shkaktuar nga reformat në sektorin e drejtësisë.

Përveç kësaj, u konstatua se mjeti i ri juridik sipas Kodit të Procedurës Civile, i miratuar në vitin 2017, nuk kishte ndihmuar në përshpejtimin e gjykimeve, duke mos i lënë ankuesit të parë asnjë mjet juridik në dispozicion për t'u marrë me shkeljen e të drejtave të tij sipas nenit 6 paragrafi 1. Megjithatë, Gjykata deklaroi se mjeti i ri juridik është në parim i pajtueshëm me nenin 13 dhe për këtë arsye, duhet të shterret përpara se të paraqiten ankesa të ngjashme në Gjykatë.

Kështu, sa më sipër, në rastin e zbatimit të reformës në drejtësi në vendin tonë prej disa vitesh tashmë, janë konstatuar vakanca të theksuara të gjyqtarëve në gjykata të niveleve të ndryshme. Njëkohësisht kjo ka passjellë zvarritje të gjykimeve të shtetasve, rrjedhimisht cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht atë që lidhet me gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Mendojmë se miratimi i propozimit të hartës gjyqësore i cili redukton dukshëm gjykatat, mund të rezultojë një reformë që do të kufizojë edhe më shumë të drejtën e qytetarëve lidhur me afatin e arsyeshëm të gjykimit të çështjeve.

Referuar raportit të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, kohëzgjatja mesatare për një çështje në nivelin e apelit është 998 ditë për çështjet penale (ose rreth 3 vjet), dhe 1742 ditë për çështjet civile (rreth 5 vjet).<sup>15</sup>

<sup>13</sup> Çështjet *Delcourt k. Belgjikës*, 17 janar 1970; *Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee k. Greqisë*, 16 nëntor 2001; *Brualla Gómez de la Torre k. Spanjës*, 19 dhjetor 1997, *Saez Maeso k. Spanjës*, 9 nëntor 2004.

<sup>14</sup> *Bara and Kola v. Albania* - [43391/18](#) and [17766/19](#), Judgment 12.10.2021

<sup>15</sup> Për më tepër, shih linkun:

Nisur nga shqetësimet që avokatët ngrenë në mënyrë të vazhdueshme në media për vonesat e gjykimit në apel, është e rëndësishme të ndërmerret një analizë e kujdesshme statistikore dhe cilësore e çështjeve që janë në proces gjykimi ose listë pritje deri në fund të këtij viti, për të ri-vlerësuar impaktin e të gjithë kësaj situatë në të drejtën për akses në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa. Kjo do të kërkonte një bashkëpunim të mirë-koordinuar midis institucioneve të sistemit të drejtësisë për të vlerësuar mënyrat alternative që mund të zhbllokojnë disi këtë situatë, të cilat jo detyrimisht mund të sjellin ndryshime në legjislacion.<sup>16</sup>

Po ashtu, rritja e distancës për të vijuar gjykimet në shkallën e parë dhe të dytë të gjykimit sipas hartës së re, do të ndikojë dukshëm në vështirësitë që do t'u paraqiten qytetarëve për të ndjekur proceset gjyqësore dhe njëkohësisht rritjen e shpenzimeve. Vakancat e gjyqtarëve reflektojnë problematikën më të madhe në funksionimin normal të gjykatave. Kjo situatë sjell pamundësi për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve, duke krijuar vonesa të konsiderueshme në dhënien e drejtësisë.

Në vlerësimin tonë, procesi i nisur për hartën gjyqësore duhet të kryhet me transparencë, si dhe duke marrë parasysh konsultimet e realizuara me palët bazuar në parimet e mirëpërcaktuara ligjore. Është thelbësore të merren parasysh sugjerimet e dhëna nga të gjitha palët, qytetarët, grupet e interesit, institucionet e pavarura dhe organizatat jofitimprurëse, duke reflektuar dhe gjetur zgjidhjen më optimale. Çmojmë se harta e re gjyqësore duhet të marrë në konsideratë dhe adresojë nevojat e qytetarëve, në mënyrë specifike të kategorive vulnerabël, shtetasit e privuar nga liria etj, për të garantuar aksesin e tyre në drejtësi dhe në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Theksojmë se mbyllja e gjykatave të shkallës së parë dhe sidomos atyre të apelit, duke lënë vetëm një të tillë në shkallë vendi, do të ndikojë në uljen e mëtejshme të besimit të qytetarëve shqiptarë në sistemin e drejtësisë, në veçanti në qytetet ku ato do të mbyllen, ndërkohë që duhet përmendur se besimi te vetë reforma në drejtësi ka pësuar rënie vit pas viti, për shkak të hapave tepër të ngadaltë me të cilët ajo po ecën, edhe pse po përmbyllet viti i gjashtë i miratimit të Reformës në Drejtësi.

Referuar Barometrit Ballkanik, sondazhit vjetor mbi vlerësimet e gjykimet që kanë qytetarët e Ballkanit Perëndimor, shqetësimet kryesore të shtetasve shqiptarë janë pasiguria dhe pamundësia socialo-ekonomike. Pakënaqësitë e tyre me jetën ranë ndjeshëm gjatë vitit 2020, ndërsa niveli i pesimizmit për të ardhmen u rrit në rekorde.<sup>17</sup>

---

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)

<sup>16</sup>[https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/05/Opinion\\_Raporti-vjetor-i-KLGJ-2021\\_-Komiteti-i-Helsinki.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/05/Opinion_Raporti-vjetor-i-KLGJ-2021_-Komiteti-i-Helsinki.pdf)

<sup>17</sup> <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications/1/>

Për gjithë sa parashtruar më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike*”, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”:

### **REKOMANDOJMË:**

- Rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, duke garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve si në gjykatat e shkallës së parë (të juridiksionit të përgjithshëm dhe atyre administrative), por në veçanti për gjykatat e apelit.
- Marrjen e masave për miratimin e një harte gjyqësore, e cila të përputhet me shtrirjen e gjykatave, sipas shpërndarjes gjeografike në territor, si dhe në mbështetje dhe zbatim të plotë të delegimit nga nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” .

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar.

***Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,***

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**